



Swedish Helsinki Committee

for Human Rights



---

# **Legjislacioni european për median dhe ai shqiptar:**

---

**Një analizë krahasuese e  
standarteve kryesore**

# **Legjislacioni europian për median dhe ai shqiptar:**

## **Një analizë krahasuese e standarteve kryesore**

### **Hyrje**

Pas firmosjes së Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) me Bashkimin Europian në 12 qershor 2006, qeveria shqiptare e ka kthyer integrimin në BE në prioritetet më të larta. Synimi për të hyrë në BE është kthyer në një motor reforme, ndërsa MSA shërben si katalizator për ndryshime konkrete. Në këtë kontekst, harmonizimi i legjislacionit shqiptar me standartet dhe legjislacionin e BE është një nga fushat ku nevojitet reformë urgjente në vend, përfshi këtu edhe legjislacionin për median.

Në këtë kuadër, Instituti Shqiptar i Medias, me mbështetjen financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit, kreu një studim krahasues të legjislacionit shqiptar për median në krahasim me standartet europiane. Kur flasim për legjislacionin e medias, objekt i këtij studimi ishin ato ligje, rregulla, standarte, etj, të cilat prekin vetëm përmbajtjen e medias dhe jo aspekte të saj të lidhura me teknologjinë. Si pasojë, ky studim shqyrton Ligjin për Radion dhe Televizionin Publik e Privat, Ligjin për Akses në Informacion, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin për Informacionin e Klasifikuar si Sekret Shtetëror, Ligjin për Shpifjen dhe Fyerjen, si dhe Ligjin për Të Drejtën e Autorit.

Edhe pse nuk pretendon të jetë shteruese, kjo analizë përpiqet të krahasojë standartet kryesore të vendosura nga direktivat e BE në këto fusha me legjislacionin shqiptar në fuqi në po të njëjtat fusha. Analiza të veçanta të Ligjit për Akses në Informacion apo të Legjislacionit për Shpifjen janë bërë edhe më parë. Duke u mbështetur në këto analiza, si dhe duke e thelluar më tej krahasimin me standartet e BE në këtë fushë, ky material përpiqet të sjellë një vështrim më gjithëpërfshirës të legjislacionit në fuqi si dhe të identifikojë fushat e mundshme për përmirësim.

## **Vështrim i shkurtër mbi historinë e legjislacionit të medias në Shqipëri**

Që në vitin 1990, pas dekadash kontrolli të qeverisë mbi shtypin, media shqiptare u përball me një horizont të ri lirie. Lindja e medias së pavarur, natyrshëm, u shoqërua me presion politik gjithnjë në rritje si dhe me një mungesë të theksuar profesionalizmi të gazetarëve. Këto fenomene deri në një farë mase u shpjeguan me mungesën e një kuadri të përshtatshëm ligjor.

Ndërhyrjet e para legjislative që u përpoqën të disiplinonin sjelljen e profesionistëve të medias ndodhën në 1993, kur asambleja e atëhershme miratoi Ligjin Nr. 7756 "Për shtypin". Ligji shqiptar u përshtat nga ligji i shtetit gjerman të Vestfalisë dhe pati shumë pak përpjekje për ta përshtatur atë me kontekstin shqiptar. Mendimi i njerëzve që ky ligj i prekte më shumë, komuniteti i medias, nuk u konsiderua ndërkohë që u përgatit ligji. Për pasojë, së shpejti komuniteti i medias u përball me një ligj që mund të konsiderohej shtypës.

Ligji nr. 7756 u shfuqizua tërësisht nga legjislatura e ardhshme në 1997. Për momentin, media e shkruar rregullohet me Ligjin për shtypin, i cili përbëhet vetëm nga ky pohim i përgjithshëm: "Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj." Komisioni Parlamentar për Median, komuniteti i gazetarëve, avokatët dhe të tjerë, në periudha të ndryshme që nga 1997 kanë debatuar për nevojën për një ligj më të hollësishëm për shtyp dhe për formën e mundshme që mund të merre ai, si edhe për pasojat që do të kishte për zhvillimin e medias, e për rrjedhojë edhe në konsolidimin e demokracisë. Megjithatë, deri tani kanë mbizotëruar përpjekjet për vetërregullim dhe jo rregullimi i tepërt.

Krejt ndryshe, rregullimi i medias elektronike bëhet me anë të një ligji të hollësishëm, Ligji Nr.8410 "Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat." Ky ligj, i cili është amenduar gjashtë herë që nga miratimi i tij në 1998, ka për qëllim të rregullojë me hollësi aktivitetin e medias elektronike, përfshirë këtu edhe transmetuesin publik, televizionin privat, transmetimin kabllor dhe satelitor. Në 2007 Parlamenti miratoi edhe Ligjin për Transmetimet Numerike, i cili ruan disa nga kërkesat që vendos edhe Ligji për Radion dhe Televizionin.

Ligji për Radion dhe Televizionin krijoi bazën edhe për krijimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) si organi kryesor rregullator si dhe për krijimin e Këshillit Drejtues të Radios dhe Televizionit Shqiptar (KDRTSH) si organin më të lartë drejtues të transmetuesit publik. Përveç Ligjit për Radion dhe Televizionin, ka edhe dy ligje të tjera të telekomunikacionit që janë të rëndësishme për sektorin e televizionit. Këto janë Ligji për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë si dhe Ligji për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, i cili krijoi organin e dytë rregullator, Entin Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT).

Autoriteti rregullator është një nga fushat që po pësojnë ndryshime të ndjeshme në peizazhin shqiptar të medias. Ndërhyrjet e politikës – duke u përfshirë në zgjedhjen e anëtarëve të KKRT, duke kontestuar vendimet e saj apo me mjete të tjera – shpesh e kanë ndërlikuar marrëdhënien mes rregullatorit dhe transmetuesve. Në 2006 u bënë ndryshime të rëndësishme në kuadrin rregullator, i cili kish shkaktuar një shqetësim në rritje për brishtësinë e medias përballë politikës.

Duke pretenduar që formula e përfaqësimit të balancuar të partive politike në organin rregullator nuk kishte funksionuar, qeveria paraqiti një projektligj që propozonte një përfshirje më të madhe të shoqërisë civile, shoqatave të medias, akademikëve, si dhe të aktorëve të tjerë për të propozuar grupin e kandidatëve për rregullatorin. Amendamentet ligjore e ndryshuan përbërjen e autoriteteve rregullatore nga një formulë e një përfaqësimi të balancuar politik në një përfaqësim më profesional. Megjithatë, mënyra e nxituar se si u ndryshua ligji—me një sesion parlamentar ku mori pjesë vetëm shumica—ngriti pikëpyetje për qëllimet e shumicës qeverisëse në lidhje me këtë ligj.

Një ligj tjetër drejtpërdrejt i lidhur me rregullimin e medias elektronike është Kodi Elektorale, ose më mirë disa seksione të tij që vendosin saktësinë, ndershmërinë dhe bamancimin si kritere që duhen ndjekur si nga transmetuesit publikë, ashtu edhe nga ata privatë. Në përgjithësi, monitorimi i bërë nga KKRT dhe nga organe të tjera ka treguar se, me disa përjashtime, media në përgjithësi i ka respektuar përqindjet që i takojnë çdo subjekti politik sipas ligjit.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, ligje të tjera që ndikojnë te media kanë të bëjnë me ligjin për shpifjen dhe fyerjen, ose më saktë me nenet për këë temë si në Kodin Penal, ashtu

edhe në Kodin Civil. Kodi Penal përmban dy karakteristika të rëndësishme që janë në shkelje të qartë të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Më saktë, Kodi Penal garanton një mbrojtje të posaçme për autoritetet publike dhe për më tepër, autoritetet publike ndaj të cilëve shpifet nuk kanë nevojë të ngrenë padi, pasi prokuroria mund ta ndjekë një çështje të tillë me iniciativën e saj.

Në praktikë vetëm Kodi Civil është përdorur kundër medias në vitet e fundit. Megjithatë, një nga problemet me Kodin Civil në Shqipëri qëndron në faktin se paditë për shpifje dhe fyerje nuk kanë asnjë limit kohor nga koha kur janë bërë.

Që nga nëntori 2004, dy projektligje (të përgatitura nga Justice Initiative dhe Instituti Shqiptar i Medias) të cilat propozojnë ndryshimin e Kodit Penal dhe atij Civil, priten të votohen në parlament. Këto ndryshime propozojnë të hiqen tërësisht nga Kodi Penal fyerja dhe shpifja, si dhe të vendosin, ndër të tjera, një mekanizëm që garanton proporcionalitetin e shpërblimit për dëmin e bërë. Edhe pse si qeveria, ashtu edhe deputetët kanë shprehur mbështetjen e tyre për këto ndryshime, ky projektligj mbetet ende për të kaluar në parlament.

# RREGULLIMI I AKSESIT TË INFORMACIONIT

Aksesi në informacion është një e drejtë njerëzore e njohur botërisht. Megjithatë, ashtu si ndodh me çdo të drejtë tjetër, duhet të jetë e balancuar dhe e kufizuar në disa aspekte, me qëllim që të garantohet mbrojtja e të drejtave të tjera dhe të shmangen konflikte. Në rastin e aksesit në informacion, aktet për lirinë e informimit barazpeshohen ose kufizohen me ligje për informacionin e klasifikuar dhe ligje për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është edhe rasti i Shqipërisë dhe për këtë arsye secili ligj do të analizohet veçmas.

## 1. Liria e informimit

E drejta themelore për akses të informacionit publik garantohet nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore. Në të njëjtën kohë, ky dokument themeltar përbën dhe bazën për punën dhe jurisprudencën e krijuar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Ky dokument përpiqet të garantojë plotësisht lirinë e shprehjes si një të drejtë themelore të njeriut dhe në të njëjtën kohë përpiqet edhe të mbrojë dinjitetin njerëzor kundër shpifjes apo shkeljeve të tjera të ngjashme. Më konkretisht, neni 10 garanton lirinë e shprehjes si një të drejtë të domosdoshme dhe të patjetërsueshme:

“Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit.”

Në këtë kontekst, Konventa njeh lirinë për të marrë informacion pa pasur ndërhyrje nga autoritetet publike si një të drejtë themelore të njeriut, të cilën shtetet palë të Konventës duhet të respektojnë. Gjithashtu, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka marrë vendime të rëndëshme që përbëjnë interpretime të detyrimeve të Konventës

dhe si të tilla duhen aplikuar nga gjykatat e të gjitha shteteve palë të Konventës, sa herë të ketë raste të tilla.

Përveç të drejtës themelore të përshkruar në Konventë, Rregullimi i KE Nr.1049/2001 rregullon aksesin e publikut në dokumentat e Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit Europian. Qëllimi i këtij rregullimi është të lehtësojë aksesin në dokumentat e institucioneve europiane. Sipas tij, qytetarët kanë të drejtë të shqyrtojnë çdo dokument që kanë këto institucione, të krijuara nga to apo në pronësi të këtyre institucioneve, në lidhje me të gjitha fushat e veprimtarisë së Bashkimit Europian. Aksesin në dokumente mund të mohohet vetëm për të mbrojtur interesin publik, jetën private, interesat ekonomike të një individit, proceset gjyqësore si dhe inspektimet, hetimet, apo kontrollet financiare.

Në këtë kontekst, është me interes të vërehet përkufizimin e dokumentit si “çdo përmbajtje, pavarësisht nga mediumi (i shkruajtur në letër apo i ruajtur në formë elektronike apo si incizim zanor, pamor, apo audiovizual) dhe që ka të bëjë me një çështje të lidhur me politikën, veprimtarinë dhe vendimet që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së institucionit.” Ky përkufizim i gjerë dhe specifik në të njëjtën kohë është i rëndësishëm në aspektin e zgjerimit të nocionit të dokumentit dhe të asaj që mund të quhet dokument. Përveç kësaj, aplikuesit nuk duhet të shpjegojnë arsyen pse po e kërkojnë dokumentin dhe afati për të lejuar akses në dokumente është 15 ditë pune. Në rast refuzimi, vendimi mund të apelohej për 15 ditë pune të tjera, ndërkohë që dokumentet mund të shihen aty në vend ose mund të merren me kopje.

Me qëllim që të lehtësohet aksesin në dokumente, çdo institucion duhet të sigurojë akses në një regjistër dokumentesh në format elektronik. Për më tepër, Rregullimi thotë se institucionet duhet të zhvillojnë praktika të mira administrative me qëllim ushtrimin sa më të lehtë të së drejtës për akses në informacion. Për më tepër, secili institucion boton një raport vjetor që përmban numrin e rasteve kur institucioni ka mohuar aksesin e dokumenteve, arsyet për këtë mohim si dhe numrin e dokumenteve të ndjeshme që nuk janë përfshirë në regjistër. Të gjitha këto kushte të vendosura nga Rregullimi tregojnë angazhimin dhe respektin e BE ndaj të drejtës për akses në dokumentet publike, në përputhje me Konventën dhe vendimet e Gjykatës Europiane.

Së fundmi, eskziston edhe një direktivë tjetër që rregullon të drejtën e informacionit, Direktiva 2003/4/EC për Aksesin Publik të Informacionit Ambiental. Edhe pse ky është një akt për informacion të posaçëm për ambientin dhe për zbatimin dhe monitorimin nga Komuniteti të ligjit për ambientin, përsëri ky është një akt që ka të bëjë me aksesin në informacionin zyrtar. Si i tillë, ai përforcon parimet e të drejtës për të marrë informacion, duke vendosur një sërë modalitetesh dhe kushtesh në këtë drejtim. Megjithatë, meqë kjo direktivë është specifike për temën dhe është në funksion të Konventës së Aarhus, analiza e saj e mëtejshme i kalon qëllimet e këtij materiali dhe nuk do të trajtohet më tej në hollësi.

### **Legjislacioni shqiptar për aksesin në informacion**

Legjislacioni shqiptar garanton të drejtën për akses të dokumenteve publike. Kjo e drejtë njihet që në nenin 23 të Kushtetutës:

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Kjo e drejtë trajtohet më gjerë në Ligjin për Akses të Dokumentave Zyrtare, Ligji nr.8503, i datës 30.06.1999. Sipas këtij ligji, “secili ka të drejtën, sipas kërkesës që bën, të marrë informacion për një dokument zyrtar pa qenë i detyruar të shpjegojë arsyet për këtë kërkesë.”<sup>1</sup> Të përjashtuara janë ato dokumente që janë të klasifikuara në bazë të ligjeve të tjera (si Ligji për Sekretet Shtetërore apo Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), por në raste mohimi, autoriteti publik duhet të japë shpjegim me shkrim të arsyeve të refuzimit<sup>2</sup>. Marrja e dokumenteve zyrtare mund të ketë një tarifë të caktuar në rastet kur shkaktohen shpenzime, por në çdo rast, tarifat nuk duhet të tejkalojnë kostot e drejtpërdrejta të dhënies së informacionit.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Ligji nr.8503 “Për të drejtën e informacionit për dokumentat zyrtare,” 30.06.1999, neni 3, më tej i quajtur Ligji për Akses në Informacion.

<sup>2</sup> Ibid, neni. 4

<sup>3</sup> Ibid, neni. 13.

Një temë e ndjeshme për këtë ligj ka qenë ajo e afateve, sidomos në rastin e gazetarëve, të cilët duhet të respektojnë afatet gjithë kohën. Sipas këtij ligji, autoriteti publik vendos nëse duhet ta pranojë kërkesën për informacionin brenda 15 ditëve<sup>4</sup>, dhe në raste pranimi, kërkesa duhet plotësuar brenda 30 (40) ditëve nga pranimi i saj.<sup>5</sup> Gjatë diskutimit të projektligjit gazetarët e kundërshtuan këtë nen, duke pretenduar se vonesa e marrjes së informacionit nuk ishte në dobi të gazetarisë cilësore.

Këto afate kanë tërhequr vëmendjen edhe në analizat dhe rekomandimet e bëra nga organizatat ndërkombëtare. Për shembull, një analizë e bërë nga Article 19, me kërkesën e OSBE, vëren se periudha 15-ditëshe e marrjes së vendimit është në përputhje me standartet ndërkombëtare, por “afati 40-ditësh për të dhënë informacionin është një vonesë e papranueshme për t’iu përgjigjur kërkesave të informacionit dhe nuk përputhet me periudhën më të shkurtër që duhet për të marrë vendimin.”<sup>6</sup> Në fakt, duke pasur parasysh se Rregullim i KE 1049/2001 i përmendur më sipër përcakton afatin prej 15 ditë pune si kufirin maksimal të kohës për të refuzuar ose për të lejuar akses, ky afat përplaslet haptas me rregullat e BE.

Në fakt, në 2007, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, në bashkëpunim me Justice Initiative nisën një rishikim të ligjit ekzistues, duke synuar të çonin amendamentet përfundimtare para parlamentit pas një procesi këshillimi me aktorët e rëndësishëm. Propozimet në fjalë<sup>7</sup> lidhen me aspekte të ndryshme të këtij ligji, në lidhje me përkufizimet, qëllimin, kufizimet dhe modalitetet. Një nga propozimet më të rëndësishme për ndryshimin e ligjit lidhet me zgjerimin e gamës së subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji. Ligji ekzistues e përkufizon “autoritetin publik” si organ të administratës shtetërore dhe ente publike dhe i detyron këto organe të lejojnë aksesin e dokumentave zyrtare. Propozimi i ri kërkon që jo vetëm zyrtarët publikë, por edhe personat fizikë apo juridikë që përfitojnë nga fondet publike të lejojnë aksesimin e dokumeneve që lidhen me fonde publike. Përveç kësaj, edhe persona fizikë apo ligjorë që përmbushin funksione publike apo administrative (si kompani private që kanë koncesione ose monopole të furnizimit me ujë, me energji

---

<sup>4</sup> Ibid, neni. 10.

<sup>5</sup> Ibid, neni. 11.

<sup>6</sup> Article 19, “Memorandum për Ligjin shqiptar për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtare,” të kërkuar nga OSBE, shtator 2004.

<sup>7</sup> Informacioni i mëposhtëm është i bazuar te Open Society Justice Initiative “Propozimet për amendimin e Ligjit për Akses në Informacion,” 6 mars, 2007.

elektrike, etj.) duhet të lejojnë aksesin në dokumente të tyre në këtë drejtim. Ky ndryshim është i rëndësishëm si për përkufizimin më të qartë të “autoritetit publik,” ashtu edhe për një rritje të përgjegjshmërisë së këtyre organeve/personave ndaj publikut.

Një tjetër problem i rëndësishëm në diskutimet për amendamentet e ligjit ekzistues ka qenë përkufizimi i qartë i rasteve kur mund të refuzohet dhënia e informacionit. Ligji ekzistues thotë vetëm se informacioni nuk jepet në ato raste kur klasifikohet me ligj dhe ky përcaktim i vakët lë vend për spekulim. Kështu, propozimi në këtë aspekt konsiston në hartimin e një liste shteruese të kritereve kur informacioni mund të mohohet, gjithnjë duke pasur parasysh përdorimin e testit të interesit publik, gjë që në ligjin ekzistues mungon.

Si u përmend edhe më sipër, çështja e afateve ka qenë mjaft problematike që nga momenti i parë që ligji u miratua dhe është e qartë që nuk përputhet me rregullat e BE në këtë aspekt. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh edhe ecurinë e administratës gjatë kësaj kohe dhe standartet ndërkombëtare në këtë fushë, amendamenti propozon që të hiqet regjimi me dy etapa (në fillim miratimi i kërkesës dhe pastaj dhënia e informacionit) dhe shkurtimi i afatit për të dhënë informacion ose për ta refuzuar kërkesën në 10 ditë, me një tolerance prej pesë ditësh të tjera në raste të kërkesave të ndërlikuara.

Propozime të tjera për amendimin e ligjit ekzistues dhe për ta sjellë atë në përputhje me standartet ndërkombëtare konsistojnë në modalitetet e dhënies së informacionit. Për shembull, kërkuesi i informacionit mund të zgjedhë formatin e preferuar (të shtypur apo elektronik). Përveç kësaj, propozimi kërkon një qëndrim më aktiv të institucioneve dhe autoriteteve publike në udhëzimin e qytetarëve për informacionin që kërkojnë, duke pasur parasysh që administrata është në një pozicion më të favorshëm se qytetarët për të gjetur dokumentat.

Krijimi i strukturave të duhura për dhënien e informacionit është një shqetësim tjetër që trajtohet në propozimin për ndryshimin e ligjit. Një sugjerim në këtë drejtim është krijimi i një zyre për informacionin në të gjitha institucionet publike, detyra kryesore e së cilës do të jetë dhënia e informacionit që kërkojnë qytetarët. Ndërsa ligji ekzistues

përmend se autoritetet publike duhet “të krijojnë strukturat lehtësuese për dhënien e dokumentave zyrtare publikut,” krijimi i këtyre zyrave ose strukturave nuk është i detyrueshëm sipas këtij përkufizimi.

Në po të njëjtën vazhdë mendimi, një nga problemet kryesore në zbatimin e ligjit ekzistues është mungesa e një sistemi të shpejtë dhe efikas për ankesat. Qytetarët preferojnë të dorëzohen në rastet kur administrata u mohon dokumente sesa të nisin padi të kushtueshme, të gjata dhe me një përfundim të pasigurtë. Ndërsa Avokati i Popullit ka rolin e mbikqyrësit të zbatimit të ligjit, ky përkufizim i paqartë dhe mungesa e kompetencave të qarta nuk krijojnë mundësinë për një zbatim më të mirë të ligjit në praktikë. Nga ana tjetër, dhënia e mundësisë për të sjellë ankesën dhe çështjen para Avokatit të Popullit do ta përmirësonte më tej mundësinë e publikut për të marrë informacion, pa qenë nevoja për të vajtur në gjykatë. Përveç kësaj, si çështjet gjyqësore, ashtu edhe shpërblimet materiale ose jo-materiale janë shumë të ngadalta dhe jo efikase. Një përkufizim më i mirë i sanksioneve dhe procedurave të dëmshpërblimit do ta përshpejtonte dhe përmirësonte zbatimin e ligjit.

## **2. Informacioni i klasifikuar**

Klasifikimi, posedimi, shpërndarja dhe deklasifikimi i sekreteve shtetërore është rregulluar nga Ligji i Informacionit të Klasifikuar si Sekret Shtetëror, të miratuar në shkurt 1999 dhe të amenduar në maj 2006. Kur u miratua në fillim, ligji mbushi boshllëkun e krijuar pas miratimit të Kodit Penal në 1995, i cili ndëshkonte shpërndarjen e sekretit shtetëror, por nga ana tjetër nuk e përcaktonte se çfarë ishte sekretit shtetëror dhe cilat do të ishin procedurat për klasifikimin e informacionit.<sup>8</sup> Ky ligj e përcakton sekretin shtetëror si çdo informacion i klasifikuar që, nëse do të nxirret në një mënyrë të paautorizuar, do të rrezikonte sigurinë kombëtare.<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore, “Liria e Shprehjes: Ligji dhe rastet gjyqësore,” 2003, f.37.

<sup>9</sup> Ligji nr. 8457 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror,” 11.02.1999, më tej i quajtur “Ligji i Informacionit të Klasifikuar.”

Informacion që mund të klasifikohet përfshin informacionet për<sup>10</sup>:

- ❖ plane, armë, operacione ushtarake;
- ❖ sistemet, instalimet, projektet dhe planet e lidhura me sigurinë kombëtare;
- ❖ veprimet, format, metodat e shërbimit të inteligjencës dhe të sistemit të shifrimit;
- ❖ informacioni i qeverive të huaja, marrëdhëniet ndërkombëtare, burimet konfidenciale;
- ❖ çështjet shkencore, ekonomike, teknologjike të lidhura me sigurinë kombëtare;
- ❖ kategori të tjera informacioni të klasifikuara si sekrete shtetërore nga personat e autorizuar.

Në varësi të llojit të informacionit, ligji i ndryshuar ravigjeron katër nivele rëndësie të informacionit të klasifikuar<sup>11</sup>:

- ❖ i kufizuar: dhënia e paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efikasitetin e organeve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare;
- ❖ konfidenciale: dhënia e paautorizuar mund të dëmtojë sigurinë kombëtare;
- ❖ sekrete: dhënia e paautorizuar mund të rrezikojë shumë sigurinë kombëtare;
- ❖ shumë sekrete: dhënia e paautorizuar mund të rrezikojë jashtëzakonisht shumë sigurinë kombëtare.

Ndryshimi i ligjit, i cili shtoi një nivel të katërt klasifikimi në nivelet ekzistuese, provokoi reagim sidomos nga organizatat ndërkombëtare. “Përkufizimi i “informacionit të kufizuar” në këtë projektligj është kaq i gjerë saqë e bën të drejtën për informacion të pakuptimptë,” tha Darian Pavli, ekspert për lirinë e informacionit në Justice Initiative. “Ky klasifikim i ri krijon një vorbull pa fund për të mohuar kërkesa të ligjshme për marrje informacioni.”<sup>12</sup> Qeveria, e cila i propozoi këto

---

<sup>10</sup> Ligji i Informacionit të Klasifikuar, neni. 4.

<sup>11</sup> Ibid, neni. 3.

<sup>12</sup> Open Society Justice Initiative, “Projektligji shqiptar për sekretet kërcënon lirinë e informacionit,” 10 shkurt, 2006, e parë në: [http://www.justiceinitiative.org/db/resource2?res\\_id=103097](http://www.justiceinitiative.org/db/resource2?res_id=103097)

ndryshime, propozoi që qëllimi i vetëm është plotësimi i kërkesave të NATO-s për klasifikimin e informacionit dhe ligji u miratua në parlament.

### **3. Mbrojtja e të dhënave personale**

Direktiva 95/46/EC është teksti i referencës në nivel evropian për mbrojtjen e të dhënave personale. Ajo vendos një kornizë rregullatore që kërkon të vendosë një ekuilibër midis një niveli të lartë mbrojtjeje të privatësisë së individëve dhe lëvizjes së lirë të të dhënave personale brenda BE. Kjo Direktivë aplikohet për të dhënat e procesuara me mjete automatike (p.sh. bazë të dhënash e kompjuterizuar e klientëve) dhe të dhëna që janë pjesë e një sistemi arkivues të paautomatizuar (p.sh. dosjet tradicionale të shtypura).

Parimi kryesor i Direktivës konsiston në krijimin e një kornize që lejon procesimin e ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Kështu, personi duhet të njoftohet për përpunimin e të dhënave të tij dhe dhënia e pëlqimit nga ana e tij është i domosdoshëm. Përveç kësaj, është e ndaluar të përpunohen të dhënat personale mbi origjinën racore apo etnike, bindjet politike, fetare apo filozofike, anëtarësia e sindikatave apo përpunimi i të dhënave në lidhje me shëndetin apo orientimin seksual. Megjithatë, përjashtime mund të bëhen në ato raste kur përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetësore të personit në fjalë ose me qëllim të diagnostikimeve mjekësore.

Gjithashtu, përpunuesi i të dhënave duhet të njoftojë personin e interesuar nga i cili merren të dhënat për identitetin e përpunuesit, qëllimin e përpunimit, marrësit e të dhënave, etj. Gjithashtut, personi të dhënat e të cilit përpunohet duhet të ketë akses në këto të dhëna si dhe mundësinë për t'i ndryshuar ato. Në përgjithësi, personi nga i cili merren të dhëna ka të drejtën të refuzojë dhënien e tyre në qoftë se ka arsye për këtë. Ky person duhet të njoftohet paraprakisht nëse të dhënat e tij personale i jepen të tretëve me qëllime të drejtpërdrejta marketingu dhe t'i jepet shprehimisht e drejta për të kundërshtuar këtë proces.

Ashtu si me çdo të drejtë për të dhënë ose mohuar informacion, edhe në rastin e përpunimit të të dhënave personale ka disa përjashtime dhe, ashtu si mund të pritet, këto përjashtime duhet të kalojnë testin e interesit publik. Më konkretisht, arsyet për dhënien e të dhënave personale janë të lidhura me garantimin e disa aspekteve të tilla si siguria kombëtare, mbrojtja, siguria publike, çështjet gjyqësore, interesa të rëndësishme ekonomike ose financiare të një shteti anëtar të BE ose mbrojtja e vetë subjektit që ka të dhënat. Së fundmi, çdo shtet anëtar duhet të krijojë një ose më shumë autoritete publike të pavarura për monitorimin dhe zbatimin e këtyre rregullave brenda territorit të shtetit anëtar që zbaton këtë direktivë.

Një direktivë tjetër që ka për objekt të saj mbrojtjen e të dhënave personale është Direktiva 2002/58/EC për privatësinë e komunikacioneve elektronike, e amenduar më vonë nga Direktiva 2006/24/EC. Kjo Direktivë përpiqet të trajtojë problemet që sjell zhvillimi teknologjik në lidhje me shkeljen e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Direktiva trajton një sërë çështjesh me ndjeshmëri të ndryshme, si ruajtja e të dhënave të lidhjes nga shtetet anëtare për qëllime mbikqyrjeje polixore, dërgimi i mesazheve elektronike të padëshiruara, përfshirja e të dhënave personale në direktoritë publike, etj.

Më konkretisht, Direktiva përforcon parimin bazë që shtetet anëtare, me anë të legjislacionit kombëtar, duhet të garantojnë konfidencialitetin e komunikacionit të bërë nëpërmjet një rrjeti elektronik publik. Në mënyrë të veçantë ato duhet të ndalojnë dëgjimin, përgjimin dhe ruajtjen e komunikacioneve nga persona të tjerë përveç përdoruesve, me përjashtim të rasteve kur këta të fundit japin pëlqimim. Përveç kësaj, qytetarët europianë duhet të japin pëlqimin para se numrat e tyre të telefonave (fikse ose celularë), adresat e e-mail dhe adresat postare të shfaqen në direktori publike. Duke adresuar edhe probleme të tjera të lidhura me teknologjinë, kjo Direktivë siguron një mbrojtje më të madhe për të dhënat personale dhe aksesimin, përpunimin apo shkatërrimin e tyre të paligjshëm, ndërkohë që krijon hapësirë për raste me interes publik madhor, si hetimet policore, çështjet gjyqësore, etj.

## Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale

Mbrojtja e të dhënave personale në legjislacionin shqiptar rregullohet me Ligjin nr.8517, “Për mbrojtjen e të dhënave personale,” të miratuar në 1999. Për më tepër, në 2004 Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale. Ligji në fuqi pohon se subjekti i të dhënave duhet të njoftohet dhe të japë pëlqimin për përpunimin dhe gjithashtu i njihet këtij subjekti të drejtën për të parë të dhënat e veta personale, së bashku me të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e këtyre të dhënave. Në rastet kur mendohet se ka pasur parregullsi në përpunimin e të dhënave, subjekti mund të bëjë ankim administrativ dhe të ngrejë padi, duke kërkuar dëmshpërblim.

Në krahasim me legjislacionin e BE<sup>13</sup>, që thotë se çdo shtet anëtar duhet të krijojë një ose më shumë autoritet që ka përgjegjësinë e monitorimit të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në territorin e vet, ligji shqiptar ende nuk krijon mundësinë për krijimin e një autoriteti të tillë. Avokatit të Popullit ligji i jep kompetencën e krijimit të një regjistri ankesash për përpunimin e të dhënave personale. Megjithatë, deri tani ligji nuk i jep kompetenca të tjera për zbatimin apo monitorimin e ankesave Avokatit të Popullit apo ndonjë organi tjetër që mund të marrë këtë funksion. Kjo është edhe një nga arsyet që ka sjellë zbatimin e dobët të ligjit dhe për këtë arsye edhe MSA në nenin 79 detyron Shqipërinë të krijojë organe të pavarura mbikqyrëse për një monitorim efikas të legjislacionit për mbrojtjen e të, përveç detyrimit për të përafuar legjislacionin shqiptar me rregullat e BE në këtë fushë.

Gjithashtu, ligji shqiptar siguron mbrojtje të të dhënave personale vetëm nga përpunimi i autoritetit publik: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtjen dhe përdorimin e ligjshëm të të dhënave personale, si dhe trajtimin e tyre nga autoritetet publike.”<sup>14</sup> Ky kufizim vetëm për autoritetet publike nuk përputhet me standartet e BE në këtë aspekt, të cilat kërkojnë një mbrojtje më të madhe në këtë fushë. Përveç kësaj, formulimi i ligjit duket se merr në mbrojtje vetëm personat fizikë dhe jo edhe ata juridikë. Kjo mund të sjellë në mungesën e mbrojtjes si të organizatave shqiptare,

<sup>13</sup> Rekomandimet e sugjeruara për ndryshimin e ligjit bazohen në informimin për politikën e Institutit AGENDA, “Përvoja shqiptare në harmonizimin e mbrojtjes së të dhënave me standartet europiane: Cfarë mund të mësojmë nga zbatimi i MSA?”, tetor 2007.

<sup>14</sup> Ligji Nr.8517, 22/07/1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale,” neni.1.

ashtu edhe atyre të huaja kur vjen puna për përpunimin e të dhënave të tyre në Shqipëri. Kjo është një çështje që vlen akoma më shumë për t'u sqaruar po të kemi parasysh që Direktiva e BE pohon qartë që transferimi i të dhënave personale nga një shtet anëtar në një vend të tretë nuk mund të bëhet nëse ky vend nuk siguron të njëjtin nivel mbrojtjeje.<sup>15</sup> Pra, përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me standartet e BE dhe krijimi i një autoriteti mbikqyrës janë ndër hapat që duhet të ndërmerren për të garantuar një mbrojtje më të mirë të kësaj të drejte si dhe për të përmbushur detyrimet që përcakton MSA për Shqipërinë.

---

<sup>15</sup> Përmbledhje e legjislacionit të BE, e parë në <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l14012.htm>

## **RREGULLIMI I POLITIKAVE AUDIOVIZUALE**

Politikat audiovizuale të Bashkimit European rregullohen nga Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizuale (AVMSD) 2007/65/EC, e cila erdhi në fuqi në 19 dhjetor 2007. Për momentin të gjitha shtetet anëtare pritjet ta adoptojnë në ligjet e tyre, duke zbatuar gjatë kësaj kohe Direktivën e Televizionit Pa kufij (TVWF). Direktiva TVWF (89/552/EEC), e miratuar në fillim në 3 tetor 1989, dhe më pas e ndryshuar në 23 qershor 1997, ka qenë dokumenti kryesor që rregullonte përmbajtjen në lidhje me politikat audiovizuale. AVMSD duhet të hyjë në fuqi jo më vonë se 19 dhjetori 2009 për të gjitha shtetet anëtare të BE.

Pas një periudhe diskutimesh dhe konsultimesh midis shteteve anëtare, Bashkimi European ra dakord për nevojën për të ndryshuar Direktivën TVWF Directive, duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë audiovizuale dhe daljen e faktorëve të rinj në fushën audiovizuale. Në tërësinë e saj, direktiva e re përforcon parimet themelore të Direktivës TVWF në lidhje me shërbimet audiovizuale në Europë, si diversiteti kulturor, mbrojtja e të miturve, mbrojtja e konsumatorëve, pluralizmi i medias dhe lufta kundër urrejtjes racore dhe fetare. Gjithashtu, ajo bën një përkufizim të ri të “shërbimeve audiovizuale” dhe siguron pavarësinë e rregullatorëve kombëtarë të medias.

Më konkretisht, politikat audiovizuale të BE mund të shihen në dy kënde: ai ekonomik dhe ai kulturor. Nga pikëpamja ekonomike, transmetimet elektronike dhe së fundmi media e re janë shërbime dhe si të tilla, duhen garantuar të gjitha kushtet për lëvizjen e tyre të lirë, një parim bazë i BE. Në këtë rast, marrja e lirë e shërbimeve të medias nëpër të gjitha shtetet dhe tregjet e BE, siç mishërohet në parimin e “vendit të origjinës”, duhet të garantohet nga të gjitha shtetet anëtare. Nga ana tjetër, duke pohuar se shërbimet e medias audiovizuale bëjnë pjesë në një kategori të veçantë, Direktiva e sapondryshuar thotë:

Shërbimet e medias audiovizuale janë po aq shërbime kulturore, sa ç’janë edhe ekonomike. Rëndësia e tyre në rritje për shoqëritë, demokracinë — sidomos duke garantuar lirinë e informacionit, diversitetin e mendimeve dhe pluralizmin e medias- edukimin dhe

kulturën, justifikon aplikimin e rregullave të posaçme për këtë shërbime.

Deri kohët e fundit, përdorimi i rregullave të posaçme për këto shërbime qëndronte kryesisht në rregullat negative dhe pozitive për përmbajtjen. Rregullat negative kërkonin që të gjitha shërbimet audiovizuale të respektonin mbrojtjen e të miturve, të mos nxisnin urrejtjen, të identifikonin qartë reklamën dhe forma të tjera të ngjashme, të mos përdornin reklama të fshehura, të respektonin rregullat për përdorimin e produkteve dhe sponsorizimet, si dhe të respektonin disa nga kufizimet për reklamat (p.sh. të mos bënin reklama për pije alkoolike në programet për fëmijët).

Më konkretisht, si Direktiva e vjetër TVWF dhe Direktiva e re AVMS njohin të drejtën për mbrojtje të posaçme të të miturve në transmetimet si të medias tradicionale, ashtu edhe të asaj të re. Mbrojtja e të miturve përfshin ndalimin e programeve për fëmijë ku mund të ketë pornografi ose dhunë të skajshme. Ky ndalim vlen edhe për të gjitha programet e tjera që kanë të ngjarë të dëmtojnë të miturit, me përjashtim të rasteve kur transmetohen në orare të vona, ose kur përdoren masa mbrojtëse, si kriptimi apo të ngjashme. Përveç kësaj, rekomandohet që programet të paraprihen nga sinjale të qarta pamore ose zanore për faktin nëse programi i këshillohet fëmijëve apo jo. Megjithatë, për t'u përpjekur për të mbrojtur lirinë e shprehjes në ambientin e krijuar nga shërbimet e reja të medias, Direktiva propozon kriptimin, etiketimin ose filtrimin e materialeve që ndikojnë te fëmijët.

Një aspekt tjetër që si Direktiva TVWF, ashtu edhe ajo AVMS trajtojnë është reklama. Ndërsa Direktiva TVWF vendosi disa kuota për kohën e reklamës, direktiva e re ka vendosur rregulla më të lirshme në këtë aspekt, duke pasur parasysh zgjedhjen në rritje që gëzon konsumatori. Kështu, sipas TVWF, koha e reklamës nuk mund të ishte më shumë se 15% i transmetimeve të ditës dhe jo më shumë se 20% brenda orës. Programet mund të ndërpriteshin me reklama vetëm nëse respektoheshin edhe integriteti dhe vlera e programit. Nëse këto programe do të ishin filma artistikë, atëherë ndërprerja duhej bërë një herë në 45 minuta. Me miratimin e Direktivës së re, kufiri ditor prej tre orësh për reklamën është hequr, ndërsa kufiri prej jo më shumë se 12 minuta për orë për reklamën mbetet në fuqi. Megjithatë, transmetuesit gëzojnë një liri më të madhe për të vendosur në cilat programe do të vendosin reklama dhe në çfarë kohe:

“Duke konsideruar mundësitë në rritje të shikuesve për të shmangur reklamat nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së re ....., rregullat e hollësishme në lidhje me futjen e spoteve të reklamës për të mbrojtur shikuesit nuk gjen më justifikim.”

Nga ana tjetër, ndalimi i reklamave për cigaren dhe disa produkte të caktuara mjekësore mbetet në fuqi. E reja që sjell Direktiva AVMSD është që gjithashtu ndalon reklamimin e ushqimeve dhe pijeve të dëmshme për fëmijët gjatë emisioneve të tyre. Ndërkohë, Direktiva e re është më elastike kur vjen puna për publicitetin e fshehur, të përcaktuar si “çdo formë e komunikimit komercial audiovizual që konsiston në përfshirjen e një reference për një profukt, shërbim, apo markën e tyre dhe që futet në një program në shkëmbim të pagesës ose diçkaje të ngjashme.” Direktiva thotë se publiciteti i fshehur lejohet në filma kinematografikë dhe televizivë, programet e sportit dhe programet e zbavitjes së lehtë, ose kur nuk ka pagesë, por vetëm disa mallra apo shërbime që jepen falas.

Megjithatë, të njëjtat parime si për reklama, teleshopping dhe sponsorizime përdoren edhe këtu. Më konkretisht, asnjë nga këto nuk duhet të ndikojë në përmbajtjen e programeve në mënyrë të tillë që të prekë pavarësinë editoriale të mediave. Shikuesit duhet të informohen për këto procese dhe programet nuk duhet të nxisin blerjen apo marrjen me qira të mallrave dhe shërbimeve. Përveç kësaj, është e ndaluar të bëhet publicitet i fshehur për cigaren dhe produkte të veçanta medicinale.

Një nga tiparet kryesore të Direktivës TVWF ishte kuota e transmetimit që u imponohej transmetuesve ose rrjeteve kombëtare. Pra, ata duhet t’i rezervonin 50% të kohës totale të transmetimit veprave europiane dhe 10% nga kjo kuotë duhej rezervuar për veprat “e pavarura” europiane, në mënyrë që të ruhet identiteti kulturor dhe diversiteti evropian. Lajmet dhe ngjarjet sportive nuk mund të llogariten në këtë kuotë, por kjo kuotë mund të arrihet në mënyrë progresive, në varësi të fuqisë që ka vendi dhe tiparet e veçanta të gjuhës apo kulturës. Megjithatë, çdo shtet anëtar duhej të raportonte çdo dy vjet për progresin e këtyre kuotave.

Edhe Direktiva AVMS respekton rëndësinë e veprave europiane, duke e shtrirë këtë kërkesë edhe për shërbimet e reja mediatike të videos sipas kërkesës. Megjithatë, nuk

vendosen kuota të qarta në këtë rast: “Shtetet anëtare do të garantojnë që shërbimet mediatiqe audiovizuale sipas kërkesës që operojnë në juridiksionin e tyre, ku të jetë e mundur dhe me anë të mjeteve të përshtatshme, do të bëjnë të mundur prodhimin e dhe aksesin në vepra europiane.” Për zbatimin e kësaj kërkesë, shtetet anëtare duhet t’i raportojnë Komisionit jo më vonë se 19 dhjetor 2011 dhe më pas çdo katër vjet.

### **Legjislacioni për politikat audiovizuale në Shqipëri**

Politikat audiovizuale në Shqipëri rregullohen me anë të Ligjit për Radion dhe Televizionin Publik në Republikën e Shqipërisë (më tej, Ligji për Radion dhe Televizionin) si dhe nga Ligji për Transmetimet Numerike, të miratuara në 2007. Ligji, i parë, i cili është amenduar gjashtë herë nga miratimi i tij në 1998, ka për qëllim të rregullojë me hollësi si median private, ashtu edhe atë publike. Shumica e detyrimeve ligjore për përmbajtjen e programeve vlejnë njëlloj edhe për transmetuesit publikë, edhe për ata privatë.

Shqipëria ka adoptuar pjesërisht standartet dhe ligjin evropian të medias. Në 1999, Shqipëria nënshkroi dhe ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës mbi Televizionin Transkufitar dhe Protokollin e tij Shtesë. Shumë dispozita të Ligjit mbi Radion dhe Televizionin rrjedhin prej tij dhe në këtë mënyrë përmbushin edhe disa nga kërkesat e Direktivës TVWF, si ato për sponsorizimet, reklamën, të drejtën e replikës dhe mbrojtjen e të miturve.

Më konkretisht, neni 36 i ligjit thotë:

Radioja publike dhe private dhe programet televizive duhet të respektojnë dinjitetin personal dhe të drejtat themelore, paanshmërinë, tërësinë dhe pluralizmin e informacionit, të drejtat e fëmijëve dhe të adoleshentëve, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat e njeriut dhe ato kushtetuese të qytetarëve, të minoriteteve kombëtare, në përputhje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, si edhe diversitetin fetar në Shqipëri.

Edhe masat për sponsorizimet janë të rëndësishme në këtë aspekt. Neni 59 e përkufizon sponsorizimin si “kontributi direkt ose indirekt nga ana e një personi fizik ose juridik për një program radioje dhe televizioni, me qëllim promovimin e emrit, kompanisë prodhuese ose të imazhit të atij personi”. Në asnjë rrethanë sponsori nuk duhet të përzihet me përmbajtjen ose me kohën e programit të sponsorizuar. Lajmet dhe informacioni nuk duhet të jetë i sponsorizuar. Kur një program është i sponsorizuar atëherë duhet të jepet edhe ky informacion. Megjithatë, personat fizikë dhe juridikë, aktiviteti i të cilëve konsiston në prodhimin, shitjen ose ofrimin e mallrave dhe shërbimeve që janë të ndaluara me ligj, nuk mund të veprojnë si sponsorë.

Reklamat rregullohen me një kapitull të veçantë të Ligjit për Radion dhe Televizionin. Reklamat nuk duhet të jenë mashtruese dhe duhet të identifikohen qartë si të tilla, ndërsa reklamat me titra janë të ndaluara. Përveç këtyre kërkesave të përgjithshme. Ligji për Radion dhe Televizionin ndalon:

1. reklamat që ndikojnë përmbajtjen e programeve
2. reklamat që nxisin pornografinë dhe dhunën
3. reklama për prodhimet e duhanit
4. reklama për armët dhe pajisjet ushtarake
5. reklama e t të mos prezantohen nga folës profesionistë, ose lajmërues programesh të punësuar në stacionet e transmetimit publik
6. reklamat indirekte
7. reklamat ateiste dhe fetare
8. reklama për ushqime që nuk janë miratuar nga organe kompetente, sipas nenit 19 të Ligjit nr.7941 (31 maj 1995), “Për ushqimin”
9. reklama për partitë dhe shoqatat politike, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj
10. reklama në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Të ndaluara janë gjithashtu reklamat për medikamente që nuk janë prodhuar dhe miratuar sipas ligjeve në fuqi ose që nuk pasqyrojnë efektet e medikamentit ashtu siç është përshkruar nga autoritetet kompetente. Reklama për pijet alkoolike është gjithashtu e kufizuar, ndërsa Ligji mbi Konkurrencën ndalon reklamat krahasuese kur krahasimi nuk mund të vërtetohet në mënyrë objektive.

Reklamat mund të futen midis programeve, si edhe në mes të programeve, me kusht që të mos preket integriteti dhe vlera e programeve. Sipas nenit 52, reklamat duhet të jenë në përputhje me integritetin e programeve që ato ndërpresin dhe këto ndërprerje nuk duhet të ndodhin më shpesh se një herë në 20 minuta. Kjo periudhë nuk është në linjë me kërkesat e TVWF, duke pasur parasysh se periudha minimale e ndërprerjes me reklama është 30 minuta. Nga ana tjetër, kërkesat e Direktivës respektohen në lidhje me ndërprerjen e filmave artistikë, që mund të bëhen çdo 45 minuta. Gjithashtu, ligji ndalon futjen e reklamave gjatë transmetimit të shërbimeve fetare. Lajmet, dokumentarët dhe programet e fëmijëve që nuk zgjasin më shumë se gjysmë ore nuk ndërprehen me reklama. Për më tepër, ligji ndalon transmetimin e reklamave që nxisin sjellje që rrezikojnë shëndetin dhe zhvillimin normal psikik të fëmijëve, sidhe reklamat për pije alkoolike të të gjitha llojeve nuk duhet t'u drejtohen fëmijëve dhe fëmijët nuk mund të shfaqen në reklama duke mbajtur pije alkoolike.

Në lidhje me transmetimet e reklamave, neni 53 kufizon zgjatjen e transmetimeve të reklamave në 15 përqind të kohës totale të transmetimit dhe në jo më shumë se 12 minuta për orë transmetimi. Në këtë aspekt, kuotat janë në përputhje me Direktivën TVWF, edhe pse ligji shqiptar ka vendosur kufizime më të mëdha për transmetuesit radiofonikë, të cilët nuk duhet të përdorin më shumë se 10 përqind të kohës totale të transmetimit për reklamat.

Gjithashtu, neni 43 i referohet transmetimeve të filmave kinematografikë dhe televizivë të përshtatshëm për fëmijët, në përputhje me kërkesat e TVWF:

“Veprat kinematografike (përveç rasteve të marrëveshjeve midis transmetuesit dhe atij që ka të drejtën e autorit) mund të transmetohen në televizion vetëm 2 vjet pas shfaqjes së parë të kësaj vepre në sallat kinematografike të vendit të origjinës. Për veprat e prodhuara në bashkëpunim me kompanitë televizive ky afat reduktohet në 1 vit, kur me marrëveshje nuk vendoset ndryshe.

Filmat dhe programet, që janë të ndaluara të shfaqen në kinema, nuk shfaqen në televizion.

Filmat e ndaluar për fëmijët nën moshën 14 vjeç nuk shfaqen në televizion as pjesërisht prej orës 6:00 deri në orën 20:00 të ditës tjetër.”

Për më tepër, autoriteti rregullator ka nxjerrë udhëzime për përdorimin e sinjaleve vizuale dhe zanore që tregojnë nëse programi rekomandohet për fëmijët, në përthje me amendmentin që iu bë Direktivës TVWF në 1997. Megjithatë, kjo duhet të vihet ende në ligj, pasi në formën e tanishme nuk ka forcë ligjore, edhe pse stacionet kryesore televizive e respektojnë atë. Në një aspekt më pozitiv, neni 6 i Ligjit për Transmetimet Numerike thotë se operatorët e rrjeteve dhe transmetuesit e përmbajtjes në transmetimet numerike duhet të garantojnë respektimin e rregullave të etikës dhe të kriptojnë ose kodojnë programe që i drejtohen grupeve të veçanta. Megjithatë, ky nuk përbën një përkufizim të qartë për atë se cilat programe duhen koduar për të mbrojtur të miturit. Praktika deri tani ka qenë ajo e kodimit të programeve erotike ose pornografike, ndërsa dhuna është transmetuar pa kufizime.

Ligji në fuqi për Radion dhe Televizionin rregullon me hollësi të drejtën për replikë, që është një tjetër kërkesë e bërë nga direktivat e BE. Neni 47 i këtij ligji thotë se përgënjeshtrimi transmetohet pa pagesë në programin e ardhshëm të rradhës ose në një kategori të ngjashme programesh, pasi pala që kërkon të drejtën për replikë ka sjellë dëshmi që informacioni i transmetuar për të është i rremë dhe që interesat e tij të ligjshme janë dëmtuar. Këtu përjashtohen rastet kur faktet kanë dalë gjatë seancave të parlamentit ose çështjeve gjyqësore dhe në këtë rast mund të thuhet që standartet e mbrojtjes janë në përputhje me standartet ndërkombëtare për shpifjen dhe fyerjen. Ligji gjithashtu shpjegon me hollësi rastet kur përgënjeshtrimi mund të refuzohet, duke ia lënë përgjegjësinë e ndërmjetësit autoritetit rregullator dhe në qoftë se kjo nuk ka sukses, gjykatës.

Legjislacioni shqiptar për median nuk i ka adoptuar ende kërkesat e Direktivës TVWF për teleshopping dhe transmetimin e veprave europiane. Ligji për Transmetimet Numerike përfshin edhe kërkesën për të transmetuar 50% vepra europiane në programin e një stacioni, duke lënë mundësinë që kjo kuotë të arrihet në mënyrë progresive. Megjithatë, përmbushja e këtyre standarteve duhet monitoruar, pasi ky ligj është ende shumë i ri. Pati një ide për të krijuar një grup pune me ekspertë të pavarur të medias, të cilët do të rishikonin Ligjin për Radion dhe Televizionin dhe do të propozonin ndryshimet e ta sillnin në përputhje me ligjin e BE. Megjithatë, me daljen e përparësive të reja që dolën në reformën ligjore dhe ngjarje të tjera që pasuan, për momentin nuk ka patur ende ndryshime.

## **RREGULLIMI PËR SHPIFJEN DHE FYERJEN**

Nuk ekziston rregullim i përbashkët në BE për ligjet e shpifjes dhe fyerjes. Në vend të kësaj, fryma e përgjithshme në këtë fushë është vendosur nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore. Në të njëjtën kohë, ky dokument themelor përbën edhe bazën për punën dhe jurisprudencën e shqyrtuar nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky dokument përpiqet të garantojë plotësisht lirinë e shprehjes si një të drejtë njerëzore themelore dhe në të njëjtën kohë ruan edhe dinjitetin njerëzor kundër shpifjes dhe shkeljeve të tjera të ngjashme. Më konkretisht, neni 10 i përkushtohet respektit për lirinë e shprehjes si një të drejtë themelore dhe të patjetërsueshme:

“Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit.”

Si mund të shihet, paragrafi i parë i këtij neni mishëron të drejtën e pamohueshme për lirinë e shprehjes, duke theksuar nevojën që autoritetet nuk duhet të imponohen, të ndikojnë ose kufizojnë këtë të drejtë. Në këtë kontekst, ky nen themelor i Konventës, sidomos për fushën e medias, garanton të drejtën për lirinë e shprehjes dhe lirinë e marrjes së informacionit.

Megjithatë, si ndodh në çdo rast, kjo e drejtë vjen edhe me kufizimet përkatëse, në mënyrë që të mos konfliktojë me të drejta të tjera dhe të arrihet një ekuilibër i përshtatshëm. Më konkretisht, paragrafi i dytë i të njëjtit nen thotë:

“Ushtimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të

tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Pra, paragrafi i dytë vendos qartë disa kufizime për lirinë e shprehjes të cituar më parë, në mënyrë që kjo e drejtë të mos përplasat me interesin publik, si siguria kombëtare, siguria publike, parandalimi i krimit, apo mbrojtja e shëndetit dhe moralit. Ajo që ka më shumë rëndësi për ligjin për shpifjen dhe fyerjen nën shqyrtim këtu, ky paragraf kufizon ushtrimin e lirisë së shprehjes “për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve.” Për rrjedhojë, ligjet për shpifjen dhe fyerjen në vendet që janë palë të Konventës, përfshirë edhe Shqipërinë, duhet të përpiqen të arrijnë këtë ekuilibër delikat, por të domosdoshëm midis këtyre të drejtave themelore.

### **Legjislacioni shqiptar për shpifjen dhe fyerjen**

Legjislacioni i tanishëm shqiptar për shpifjen rregullohet si me ligjin kriminal, ashtu edhe me atë civil. Megjithatë, një nismë e përbashkët e Open Society Justice Initiative, dhe Institutit Shqiptar të Medias ka kërkuar mbështetjen e deputetëve për të miratuar ndryshimet ligjore që kanë për qëllim të dekriminalizojnë shpifjen dhe fyerjen, të cilat për momentin po shqyrtohen në parlament. Objektivi i këtyre amendamenteve është të hiqen tërësisht masat në Kodin Penal në lidhje me shpifjen dhe fyerjen dhe të përmirësohet Kodi Civil.

### **Rregullimi me Kod Penal**

Për Momentin Kodi Penal përmban dy nene kryesore: njëri për fyerjen dhe tjetri për shpifjen. Neni 119, për fyerjen, është si më poshtë:

"Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit."

Padia duhen bërë nga viktima. Kur vjen puna te ndëshkimet, ato për fyerje janë disi më të ulëta: gjobë ose deri në gjashtë muaj burgosje, në krahasim me ato për shpifjen në nenin 120:

"Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër që dihet se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Po kjo veprë, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet."

Sipas të njëjtave nene, kur këto akte kryhen në mënyrë publike, që përfshin edhe median, sanksionet janë të njëjta për të dyja shkeljet: gjobë ose deri në dy vjet burg. Nuk bëhen dallime nëse ai që bën shkeljen është gazetar apo jo; ligji vlen për të gjithë qytetarët dhe për rrjedhojë për të gjithë gazetarët, pavarësisht nga lloji i medias ku ata punojnë.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet në këtë aspekt për qasjen ligjore ndaj autoriteteve publike. Eksiztojnë nene të caktuara në Kodin Penal që kanë për qëllim të parandalojnë fyerjen dhe shpifjen e zyrtarëve publikë, duke thënë se fyerdja dhe shpifja e qëllimshme të bëra ndaj një zyrtari përbëjnë shkelje penale dhe dënohem secila me gjobë ose deri në një vit burgim. Ndëshkimet janë më të larta nëse këto akte kryhen publikisht, duke arritur deri në dy vjet burgim. (nenet 239, 240.) Pra, këto nene ngrenë sanksionet për zyrtarët publikë në rastet e fyerjes, ndërsa sanksionet për shpifjen janë të njëjta.

Përveç kësaj mbrojtjeje më të madhe, Kodi Penal favorizon zyrtarët publikë edhe në një aspekt tjetër: zyrtarët publikë të cilët fyhen ose për të cilët është shpifur, nuk kanë nevojë të ngrenë padi për këtë gjë, pasi çështjen mund ta hapë edhe vetë prokuroria<sup>16</sup>. Sanksionet më të rënda për shpifjen dhe fyerjen kundër zyrtarëve publikë dhe përndjekja me nismën e prokurorisë janë ndoshta pjesa më problematike kur vjen puna për të shqyrtuar impaktin e legjislacionit dhe çështjeve gjyqësore në lirinë e shprehjes. Kjo pjesë e legjislacionit shqiptar është në mospërputhje të qartë me parimin e rëndësishëm të formuluar nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit zyrtarët publikë duhet të tolerojnë një shkallë më të lartë kritike sesa personat privatë. Në fakt, organizatat ndërkombëtare që

---

<sup>16</sup> Gent Ibrahim, "Ligji për shpifjen dhe fyerjen në Shqipëri: drejt reformës," i cituar në Mediaplan Institut, "The stumbling of media in times of transition," 2005, f.159.

merren me fushatat për lirinë e shprehjes kanë rekomanduar me forcë që në vend që të sigurohet mbrojtje më e madhe për zyrtarët publikë, standartet në rastet e shpifjes dhe fyerjes kundër zyrtarëve publikë duhet të jenë shumë më të rrepta sesa standartet për personat e tjerë<sup>17</sup>.

Së fundmi, Kodi Penal përmban disa nene që kanë për qëllim të parandalojnë shpifjen dhe fyerjen e përfaqësuesve të vendeve të huaja, simbolet e himnit dhe flamurit kombëtar, të Presidentit të Republikës, simbolin e Republikës, si dhe gjykatësit, kanë qenë burim shqetësimi dhe debati për gazetarët, aktivistët e lirisë së shprehjes dhe juristët e medias. “Ndërsa gazetaërt po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë për kufijtë që i vendosen lirisë gazetareske për hir të mbrojtjes së individëve, ata kanë dyshime për nevojën e mbrojtjes së objekteve të tilla si flamuri dhe simbole të tjera.”<sup>18</sup> Një analizë ndërkombëtare e legjislacionit shqiptar për shpifjen dhe fyerjen hedh të njëjtat dyshime: “Ligjet për shpifjen dhe fyerjen nuk duhet të përdoren për të mbrojtur ‘reputacionin’ e objekteve, si simbolet e shtetit apo ato fetare, flamujt apo simbolet kombëtare; nuk mund të përdoren as për të mbrojtur ‘reputacionin’ e shtetit ose kombit si të tillë.”<sup>19</sup>

### **Rregullimi me Kod Civil**

Kodi Civil shqiptar përmban dy nene që lidhen me shpifjen dhe fyerjen, njëri për botime të pasakta ose që kanë shpifje dhe tjetri për kërkimin e dëmshpërblimit për dëmin jopasuror. Më konkretisht, neni 617 siguron të drejtën për korrigjimin e botimit të informacionit të pasaktë, të paplotë, ose të rremë. Më tej, neni 625 thotë:

Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij;

---

<sup>17</sup> Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore, “Liria e shprehjes: Ligji dhe çështjet gjyqësore,” 2003, f.30.

<sup>18</sup> <sup>18</sup> Gent Ibrahim, “Ligji për shpifjen dhe fyerjen në Shqipëri: drejt reformës,” i cituar në Mediaplan Institut, “The stumbling of media in times of transition,” 2005, f.157.

<sup>19</sup> Article 19, “Memorandum për Ligjin Shqiptar të Shpifjes dhe Fyerjes,” commissioned by OSCE, Shtator 2004, f.11.

- b) është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë.
- c) E drejta e parashikuar në paragrafin e mësipërm është e patrashëgueshme.

Sipas Article 19, këto masa nuk sigurojnë mbrojtje të përshtatshme të reputacionit. Një nga arsyt kryesore për të ndryshuar nenin e mësipërm është se ky nen “krijon mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim edhe për thënie që janë të vërteta po dëmtojnë nderin – për shembull, një dyshim i hedhur për një ministër për abuzim të fondeve shtetërore, por që provohet se është e vërtetë<sup>20</sup>. Për më tepër, ligji nuk bën dallimin midis faktit dhe mendimit, në një kohë që “pranohet botërisht që opinionet meritojnë një shkallë më të lartë mbrojtjeje.”<sup>21</sup>

Së fundmi, një nga polemikat më të mëdha me këtë nen lidhet me atë që ai i jep mundësinë individëve të ngrenë padi në emër të të vdekurve, në qoftë se këta nuk morën dëmshpërblim kur ishin gjallë. “Dëmi i një sulmi ndaj reputacionit për nga natyra është i drejtpërdrejtë dhe personal. Ndryshe nga prona, kjo është e drejtë që nuk mund të trashëgohet ...”<sup>22</sup> Për më tepër, ligji nuk arrin të krijojë kufizime për masën e dëmshpërblimit në rastet e dëmit jopasuror, gjë që u jep gjykatave një fuqi që duhet përdorur me kujdes.

### **Ndryshimet e propozuara për legjislacionin për shpifjen dhe fyerjen<sup>23</sup>**

Nisma për të ndryshuar ligjin në fuqi për shpifjen dhe fyerjen është bërë me amendamente paralele për Kodin Penal dhe Kodin Civil. Këto amendamente propozojnë të hiqet tërësisht fyerja dhe shpifja nga Kodi Penal, së bashku me nenet që sigurojnë mbrojtje më të madhe për zyrtarët e huaj dhe simbolet kombëtare. Në vend të kësaj, amendamentet sigurojnë mbrojtje vetëm për zyrtarët publikë që fyhen rëndë për shkak të detyrës, një shkelje që ndëshkohet vetëm me gjobë dhe jo më me burgim. Gjithashtu, simbolet e republikës

---

<sup>20</sup> Ibid, f.14.

<sup>21</sup> Ibid, f.15.

<sup>22</sup> Ibid.

<sup>23</sup> Informacioni në këtë seksion është nga Relacioni për ndryshimet në Kodin Penal dhe Civil, i hartuar nga grupi i punës për ndryshimin e ligjeve për shpifjen dhe fyerjen.

mbeten të mbrojtura, por sanksioni ndërrohet vetëm me gjobë dhe mund të përdoret vetëm nëse provohet qëllimi për ta shkelur ligjin.

Në mënyrë që të kompensohet dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes, grupi i punës propozoi edhe ndryshime në Kodin Civil. Së pari, amendamenti propozon të vendoset një kufizim kohor prej një viti nga momenti i shpifjes opse fyerjes, duke u përpjekur të përmirësojë nenin e tanishëm në Kodin Civil, i cili nuk vendos ndonjë kufizim kohor. “Është e qartë që ky rregullim është problematik në pikëpamjen e fjalës së lirë, pasi teksa koha kalon bëhet gjithnjë e më e vështirë për palët në një proces që të provojnë me qartësi të mjaftueshme faktet që sollën thënien e kontestuar.”<sup>24</sup>

Gjithashtu, projektligji propozon vendosjen e një lidhjeje shkak-pasojë midis veprës ose thënies së kontestuar dhe dëmit të reputacionit që perceptohet. Për më tepër, përgjegjësia kufizohet vetëm te ato raste kur një dëm ndodh si pasojë e thënies së fakteve të rreme. Abuzimi me pretendimet për dëmshpërblim për fyerjen e memorjeve të të vdekurve është kufizuar, gjithashtu. Në mënyrë që të përmbushen këto qëllime, projektligji ka krijuar një listë me rrethanat që duhen konsideruar nga gjykata kur të përcaktohet përgjegjësia e të paditurit për shpifje ose fyerje. Më konkretisht, mendimet dhe pasaktësitë e vogla faktike nuk konsiderohen më si shkelje. Gjithashtu, për herë të parë, gjykata supozohet të aplikojë testin e interesit publik. Më saktë, personi i akuzuar për shpifje dhe fyerje në lidhje me çështjet e interesit publik është përgjegjës vetëm në ato raste kur përhap informacion që e di që është i rremë.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, projektligji përpiqet të paraqisë një mekanizëm që garanton përpjestimin e dëmshpërblimit me dëmin e krijuar. Amendamentet kanë për qëllim të zvogëlojnë dëmin, kryesisht nëpërmjet botimit të përgënjeshtimit, pajtimit të palëve, duke marrë parasysh nëse kishte përfitime personale në fyerje apo shpifje, si dhe ndikimin e dëmshpërblimit duke pasur parasysh situatën financiare të të paditurit.

Procesi i ndryshimit të ligjit për shpifjen dhe fyerjen ka nisur në 2004 dhe arriti në formën aktuale pas një sërë diskutimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese të aktivistëve dhe

---

<sup>24</sup> <sup>24</sup> Gent Ibrahimi, “Ligji për shpifjen dhe fyerjen në Shqipëri: drejt reformës,” i cituar në Mediaplan Institut, “The stumbling of media in times of transition,” 2005, f.169.

nismëtarëve, si dhe grupit të punës të përbërë nga deputetë, juristë të medias, gazetarë, redaktorë, përfaqësues të shoqërisë civile, etj. Pasi mori mbështetjen me shkrim të 23 deputetëve, amendamentet u dërguan në parlament në maj 2005, por nuk u votuan dot për mungesë kohe, pasi u çuan atje menjëherë para zgjedhjeve të përgjithshme. Kjo nismë gjeti mbështetje nga disa organizata ndërkombëtare, si OSBE, Article 19, Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, etj.: “Amendamentet e propozuara për Kodin Penal dhe Civil shqiptar do ta çonin Shqipërinë më pranë krijimit të një balance të drejtë midis të drejtës së lirisë së shprehjes dhe të drejtës së reputacionit.”<sup>25</sup>

Ndërkohë, qeveria aktuale, e cila erdhi në fuqi në 2005, duket se e përkrah kauzën e dekriminalizimit të shpifjes dhe fyerjes. Kryeministri ka lëshuar një urdhër në tetor 2005, i cili thotë se zyrtarët publikë nuk duhet të ngrenë padi kriminale apo civile kundër gazetarëve për shpifje dhe fyerje; në vend të këtyre, duhen përdorur vetëm përgënjeshttrimet zyrtarë<sup>26</sup>. Ky urdhër, edhe pse i diskutueshëm në aspektin e balancimit të të drejtave të zyrtarëve publikë me lirinë e shprehjes, u pasua nga propozimi i qeverisë në Komisionin Parlamentar të Medias për miratimin e amendamenteve të ligjit për shpifjen dhe fyerjen në parlament. Për momentin, amendamentet nuk janë votuar ende në parlament.

---

<sup>25</sup> Article 19, Letër e Hapur Servet Pëllumbit, 28 prill 2005.

<sup>26</sup> Instituti Shqiptar i Medias, Albanian Media Neësletter, tetor 2005, parë në [www.institutemedia.org/newsletter](http://www.institutemedia.org/newsletter)

## **RREGULLIMI I TË DREJTËS SË AUTORIT**

Të drejtat e pronësisë intelektuale trajtohen në disa dokumente të miratuara nga institucionet e BE. Këto dokumenta janë të rëndësishme për treguin e përbashkët, pasi konsiderohen si parakusht për konkurrencën e lirë dhe të ndershme. Direktivat në fjalë rregullojnë të drejtën e pronësisë intelektuale dhe të drejta të tjera të lidhura me të dhe kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e së drejtës, me mbrojtjen e bazave të të dhënave, të drejtat e transmetimit satelitor dhe ritransmetimit kabllor, si dhe me rregullimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në shoqërinë e informacionit.

Më konkretisht, Direktiva 93/98/EEC, ka për qëllim të harmonizojë kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të, duke caktuar kohëzgjatjen e të drejtës së autorit për një vepër letrare ose artistike në 70 vjet nga vdekja e autorit ose nga data kur vepra u bë publike në ato raste kur vepra është anonime ose u prodhua me një pseudonim. Nga ana tjetër, kohëzgjatja e së drejtës për një film ose vepër audiovizuale është caktuar deri në 70 vjet pas vdekjes së personit që vdes i fundit nga këta: regjisori, skenaristi, autori i dialogut dhe kompozitori i muzikës të krijuar posaçërisht për përdorimin në vepra kinematografike apo audiovizuale. Kohëzgjatja e mbrojtjes së të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit është caktuar 50 vjet. Ky afat duhet të llogaritet rast pas rasti nga data e shfaqjes, botimit apo komunikimit të incizimit apo transmetimit të parë.

Një Direktivë tjetër që rregullon transmetimin me satelit dhe ritransmetimin me kabllor është Direktiva 93/83/EEC. Ndërsa përcakton termat e komunikimit me satelit dhe të ritransmetimit me kabllor, direktiva thotë se transmetimi me satelit i veprave me të drejtë autori kërkon autorizimin nga ai që ka të drejtën, ndërsa ritransmetimi me kabllor duhet bërë sipas ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtave që lidhen me të në çdo shtet anëtar dhe sipas marrëveshjeve midis pronarëve të së drejtës së autorit, atyre që kanë të drejtat e lidhura me këtë të drejtë dhe operatorëve kabllorë. Direktiva gjithashtu vendos detyrime për dëmshpërblim në rastin e transmetimit të veprave artistike, së bashku me mundësinë që këto pagesa të bëhen pranë një shoqërie që administron të drejtat e autorit.

Me qëllim që të trajtohen problemet që dalin për të drejtën e autorit me zhvillimet e vrullshme teknologjike, Direktiva 96/9/EC ka për qëllim të mbrojtë të drejtën e autorit për bazat e të dhënave të çdo forme, duke i përcaktuar bazat e të dhënave si "koleksion veprash, të dhënash, apo materialesh të tjera të sistemuara në një mënyrë apo metodë që mund të aksesohet në mënyrë individuale në format elektronik apo tjetër ". Ndërsa direktiva nuk merr nën mbrojtje softueret e përdorura për të krijuar ose vepruar me bazën e të dhënave, objektivi i saj është të sigurojë mbrojtje të së drejtës së autorit për krijimin intelektual në përzgjedhjen dhe arranzhimin e materlaive dhe mbrojtje *sui generis* për një investim (financiar dhe në terma të burimeve, përpjekjeve dhe energjisë njerëzore) për të marrë, verifikuar dhe paraqitur përmbajtjet e një baze të dhënash.

Direktiva 2001/29/EC merr parasysh zhvillimin e shoqërisë së informacionit në Europë dhe për pasojë edhe zhvillimin e një tregu të brendshëm për produktet dhe shërbimet e reja. Direktiva rregullon të drejtën e autorit për të komunikuar punën e tij te publike me mjete "ëire dhe ëireless" dhe mbulon tre të drejta themelore:

- Të drejtat e riprodhimit – duke lejuar të drejtën e personit në fjalë për të ndaluar riprodhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përkohshëm ose të përhershëm të çdo forme dhe me çdo mjet, të tërin apo me pjesë. Kjo vlen për autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogramëve, prodhuesit e incizimeve të para të filmave dhe organizatat e transmetimit.
- Të drejtat e komunikimit te publiku – e drejta ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar vënien në dispozicion të publikut veprat, në mënyrë të tillë që publiku mund të ketë akses te to në një vend dhe kohë që ata e zgjedhin vetë. Kjo mbulon interpretuesit, prodhuesit e fonogramëve, prodhuesit e incizimeve të para të filmave dhe organizatat e transmetimit.
- Të drejtat e shpërndarjes – e drejta ekskluzive e autorëve për të autorizuar ose ndaluar çdo formë shpërndarjeje te publiku me shitje ose me mënyrë tjetër.

Direktiva u krijon mundësinë shteteve anëtare të vendosin përjashtime ose kufizime për të drejtën e riprodhimit në disa raste. Gjithashtu, direktiva pohon se shtetet anëtare duhet të miratojnë sanksione dhe zgjidhje për shkeljen e të drejtave. Sanksionet duhet të jenë efikase, në përpjestim me dëmin dhe parandaluese.

Së fundmi, Direktiva 2004/48/EC përforcon përkufizimin e të drejtës së autorit si është në Konventën e Bernës, domethënë që e drejta e autorit lind së bashku me veprën dhe që nuk ka nevojë të kërkohet regjistrimi formal i saj. Ajo që është më e rëndësishme, direktiva thotë që shtetet anëtare duhet të krijojnë masat dhe procedurat e duhura për të garantuar zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të marrë masat e përshtatshme kundër falsifikatorëve dhe piratëve.

Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave dhe procedurave janë:

- a) mbajtësit e të drejtave të pronësisë intelektuale,
- b) gjithë personat e tjerë të autorizuar për të përdorur këto të drejta, sidomos të licensuarit, në masën që u lejohe nga ligji në fuqi;
- c) organizatat kolektive të administrimit të së drejtës së autorit, të cilat njihen se kanë këtë të drejtë dhe në masën që u lejon ligji në fuqi;
- d) organet profesionale të mbrojtjes, të cilat njihen se kanë këtë të drejtë dhe në masën që u lejon ligji në fuqi.

Direktiva krijon mundësinë për vendosjen e rregullave për të gjykuar rastet e shkeljes së të drejtës së pronësisë intelektuale dhe bën një dallim të qartë midis përdorimit personal dhe shkeljeve për “përfitim ekonomik”. Masat apo sanksionet për rastet kur provohet shkelja e të drejtës së autorit mund të përfshijnë edhe tërheqjen nga tregu apo edhe shkatërrimin e mallrave pa të drejtë autori.

### **Legjislacioni shqiptar për pronësinë intelektuale**

Ligji Nr.9380 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me të” përpiqet të garantojë me hollësi të drejtat e autorëve të çdo lloji, si dhe të drejtat e tjera në lidhje me të. Gjithashtu, Shqipëria ka ratifikuar marrëveshjet dhe traktatet më të rëndësishme në këtë fushë, si Marrëveshja TRIPS, Konventa e Bernës, Konventa e Romës, Konventa e Parisit dhe traktate të tjera për këtë aspekt të World Intellectual Property Organization.

Ky ligj mbulon si të drejtat e autorit, ashtu edhe të drejtat e lidhura me të, duke u përpjekur të jetë gjithëpërfshirës në mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Pra, ligji krijon mbrojtje për të drejtën e autorit për veprat artistike, veprat e artit të aplikuar, vizatimeve, gravurave, veprave arkitekturore, audiovizuale, koreografike, kinematografike, folklorit, veprave

muzikore, skenareve, pantomimave, përkthimeve, bazave të të dhënave, softuerit të kompjuterave, e kështu me rradhë<sup>27</sup>. Në këtë mënyrë, ligji përpiket të mbulojë çdo vepër arti apo krijim intelektual të mundshëm, në çdo formë të mundshme të përdorimit të tyre.

Ligji bën dallimin midis të drejtave pasurore dhe atyre morale, duke caktuar procedurat e caktuara për secilën. Kohëzgjatja e të drejtave të autorit për veprat letrare dhe artistike shtrihet deri në 70 vjet pas vdekjes së autorit. E njëjta gjë vlen edhe për veprat kinematografike apo veprave të tjera audiovizuale. Gjithashtu, ligji përdor të njëjtin parim të trajtimit kombëtar, duke mbrojtur të drejtën e autorit edhe për autorët e huaj, si për ata vendas. Ligji detajon një sërë kufizimesh për të drejtën e autorit dhe për termat e transferimit dhe trajtimit të përgjithshëm të të drejtës pasurore, të kontratave të botimit, të kontratave për shfaqje muzikore ose teatrore, etj.

Në lidhje me të drejtat e tjera që lidhen me të drejtën e autorit, ky ligj i jep mbështetje interpretuesve të veprës, duke bërë sërish dallimin midis të drejtës morale dhe asaj pasurore, duke siguruar edhe procedurat përkatëse për secilën. Kohëzgjatja e mbrojtjes përcaktohet në 50 vjet pas shfaqjes së parë në publik. Mbrojtje e njëjtë u rezervohet edhe prodhuesve të fonogramëve dhe të veprave kinematografike ose audiovizuale: afati i mbrojtjes së të drejtës së autorit është i vlefshëm për 50 vjet që nga incizimi i parë apo shfaqja e parë në publik. Për mbrojtjen e fotografive dhe bazave të të dhënave përcaktohen afate më të shkurtra, ndërsa e drejta e autorit e lidhur me transmetimet satelitore dhe kabllore respekton të njëjtat vlera dhe të drejta që siguron direktiva e BE për pronarët e të drejtave të autorit për programet në fjalë.

Së fundmi, ligji rregullon edhe aspektin e administrimit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të në nenet për agjencitë e administrimit të së drejtave të autorit. Këto agjenci duhet të jenë organizata jo-fitimprurëse dhe licensimi i tyre duhet të bëhet nga Ministria e Kulturës pas propozimit nga Zyra e së Drejtës së Autorit, dhe ky licensim është i detyrueshëm. Licensa është e rinovueshme dhe jepet për një afat tre-vjeçar dhe agjencitë shqiptare mund ta transferojnë të drejtën e tyre të autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të te agjencitë e huaja që mund të mbulojnë të njëjtën fushë.

---

<sup>27</sup> Ligji nr.9380 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të,” 28/04/2005, neni. 4.

Legjislacioni shqiptar parashikon një rol mbikqyrës për Zyrën e së Drejtës së Autorit, pasi të gjitha agjencitë për të drejtën e autorit janë të detyruara të dorëzojnë listën e shpërndarjes së pagesave për të drejtën e autorit çdo vit. Gjithashtu, këto agjenci duhet të paraqesin kontratat e ndryshme të punës për të drejtat e autorit në Zyrën për të Drejtën e Autorit. Kjo zyrë mund të kërkojë informacion edhe me nismën e vet për këto çështje nga agjensitë që administrojnë të drejtën e autorit. Në rast refuzimi, ministria mund të pezullojë licensën e agjensisë për gjashtë muaj.

Nenet për rolin e Zyrës për Të Drejtën e Autorit kanë qenë ndër më të diskutuarat në lidhje me këtë ligj. Pas një periudhe të turbullt, ku e drejta e autorit rrallë respektohej dhe mbretërornte pirateria, kishte një mendim që një praktikë më e centralizuar dhe e monitoruar nga shteti në këtë fushë do ta përmirësonte situatën. Nga ana tjetër, mendimi tjetër ishte se krijimi i kësaj zyre që do të ishte nën varësinë e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës dhe që do të monitoronte dhe vendoste rregulla për agjencitë e zbatimit të së drejtës së autorit mund të çonte në mundësi për ndikime politike në këtë fushë. Në kontekstin e krahasimit të rregullimit të BE në këtë fushë me legjislacionin shqiptar, kjo është një çështje që direktivat e BE ia lënë në dorë shteteve anëtare. Pra, në mungesën e rregullave më specifike në këtë fushë dhe duke patur parasysh krijimin e vonë të Zyrës për të Drejtën e Autorit dhe mungesën e saj të përvojës, do të duhet kohë për të vlerësuar suksesin ose mangësitë dhe sugjerimin e amendamenteve, nëse do të jetë e nevojshme.